

MUHARREM DEZHGIU

**QËNDRIMI POLITIK I LEF NOSIT GJATË LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE***

Lef Nosi, një ndër firmëtarët e dokumentit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, pati një veprimtari të pasur politike në vitet e para të shtetit shqiptar.

Pas një shkëputjeje nga jeta politike në periudhën 1925-1939, ai riaktivizohet përsëri në vitet e vështira të konfliktit botëror 1939-1944.

Gjatë viteve 1925-1939 patrioti Lef Nosi i kushtohet veprimtarisë kryesore duke u marrë me studime gjuhësore, historike, etnografike etj. Do të dallohej në fusha të veçanta siç ishte ajo e filatelistë, numizmatikës si dhe të mbledhjes së shprehjeve të fjalëve të urta të popullit tonë. Veç këtyre do të përgatiste libra e vëllime dokumentare për historinë tonë kombëtare¹.

Pushtimi i vendit nga Italia fashiste ishte një ngjarje e hidhur që nuk mund të pranohej nga të gjithë shqiptarët, për më tepër, për Lef Nosin, i cili kishte luftuar e kontribuar për fitoren e pavarësisë. Ai, tashmë, nuk kishte qetësinë e duhur për t'u marrë me veprimtari krijuese, kur vendi humbi pavarësinë politike. Ndaj, ai do të rreshtohet ndër të parët atdhetarë, për ta kundërshtuar dhe për t'i bërë qëndresë të vendosur pushtuesit agresor italian.

Për veprimtarinë antifashiste të Lef Nosit do të flitej në dokumentet e pushtuesit që në fillim të vitit 1940. Në një shkresë të Komandës së Lartë të Karabinierisë së Mbretërisë Shqiptare drejtuar Ministrisë së Brendshme, lidhur me një broshurë propagandistike antifashiste,

* Kumtesë mbajtur në Konferencën shkencore ndërkombëtare kushtuar Lef Nosit, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, më 24 nëntor 2012.

¹ Vëllimi *Dokumente historike 1912-1918*, botuar për herë të parë në vitet 1924-1925, u ribotua nga Instituti i Historisë në vitin 2007, që, siç e ka vënë në dukje autori, kanë qëllim "me qitë në dritë ngjarje që pasqyrojnë fazat e ndryshme të evolucionit politik të këtij vendi".

përmendej emri i Lef Nosit, si zotërues i saj² dhe dyshohej për spiunazh e për ndjenja zogiste.

Pas këtij informacioni, Ministria e Brendshme me anë të një letre rezervate, i tërhiqte vëmendjen Prefekturës së Elbasanit, ku kërkohet arsyeja për vonesën, që nuk ishte vënë në dijeni më parë “për një ngjarje me rëndësi të madhe”³, - siç thuhej.

Në fillim të dhjetorit 1940 atdhetari Lef Nosi është objekt i një promemorieje të Mëkëmbësisë së Përgjithshme Italiane në Shqipëri.⁴ Aty ai cilësohet si “patriot shqiptar, kundërshtar i politikës greke”. Edhe pse thuhej se “nuk ka manifestuar armiqësi kundrejt Italisë”, ato ditë ishte arrestuar dhe është nisur për Itali. Në promemorie vihej në dukje se “arrestimi i tij është shfrytëzuar nga armiqtë tanë, të cilët thonë se si përndiqen patriotët shqiptarë”. Nisur nga autoriteti që gëzonte Lef Nosi tek shqiptarët, Mëkëmbësia Italiane udhëzonte për mundësinë e dorëzimit të Lef Nosit në Shkodër në Kuvendin Françeskan, për të mos komprometuar “miqësinë” me shqiptarët.

Në mbrojtje të Lef Nosit, për të mos e internuar në Itali, u angazhua dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë⁵. Kryetari i kësaj Kise iu drejtua Mëkëmbësisë së Përgjithshme, sapo mësoi lajmin për Lef Nosit. Duke e cilësuar atë si “një prej atdhetarëve tanë më të mirë” kryetari i Kishës Ortodokse Autoqefale lutej të ndërhynte për të mos e dërguar në Itali, duke e arsyetuar edhe me moshën e tij të thyer. Me këto lutje të KOASH ishin bashkuar edhe priftërinjtë ortodoksë të Manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan.

Siç del nga dokumentet e mëvonshme Meloni nuk e mori në konsideratë këtë kërkesë të Kristoforit, kryetar i KOASH, por i drejtohej Attolinit në aeroport me një shkresë ku i kërkonte “të lehtësonte nisjen për në Romë të zotërinjve Lef Nosi e Hysen Plangarica”.⁶

² Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.), viti (më tej: V.) 1949, dosja (më tej: D.), fl. 7. Shkresë e Komandës së Lartë të Karabinierisë, drejtuar Ministrisë së Brendshme, 14 prill 1940.

³ Po aty, F. 152, V. 1949, D. 83, fl. 14. Shkresë e Ministrisë së Brendshme drejtuar Prefekturës Elbasan, 18 prill 1940.

⁴ Po aty, F. 161, V. 1940, D.606, fl. 38. Promemorje e Mëkëmbësisë së Përgjithshme në Shqipëri, 5 dhjetor 1940.

⁵ Po aty, fl.39, Shkresë e KOASH drejtuar Salvatore Melonit pranë Mëkëmbësisë së Përgjithshme, 6 dhjetor 1940.

⁶ Po aty, fl. 40, Shkresë e Melonit për aeroportin në Tiranë, 14.12.1940.

Kështu Lef Nosi, si shumë nacionalistë shqiptarë që nuk pranuan pushtimin dhe humbjen e pavarësisë, iu nënshtruan internimit në Itali. Gjatë kësaj kohe që Lef Nosi ishte në internim mori një letër nga studenti shqiptar në Firence Q.Stafa, i cili e vlerësonte me gjithë shpirt kontributin e dhënë për kombin.

Pikërisht për këtë njohje e konsideratë për të, Qemali e përfundonte letrën me gatishtërinë për të qenë “përherë në dispozicion të tij, kur të jetë nevoja”.

Edhe pas kthimit nga internimi emri i Lef Nosit ishte i pranishëm në dokumentet e shkresat e administratës së pushtuesit. Ministria e Brendshme i dërgonte Prefekturës së Elbasanit një urdhër urgjent, më 24 shkurt 1942, ku i kërkohej “të caktonin elementët më të rrezikshëm për sigurimin botuer nga pikëpamja politike, ku të thuheshin edhe paditë që rëndonin mbi ta.⁷ Në përgjigje të këtij urdhri emri i Lef Nosit ndodhej i dyti në listë pas mësuesit Mustafa Shqerra, që konsiderohej “shumë i rrezikshëm pse është zogist e prandaj kundër regjimit (të pushtimit)”. Ndërsa për Lef Nosin jepej shënimi “Ardhur nga internimi. Dyshohet si filoanglez”.

Gjatë periudhës së pushtimit italian pozita politike e Lef Nosit u përcaktua qartë dhe prerë si një nacionalist i vendosur në qëndresën kundër pushtuesit, me qëllimin e vetëm të rifitores së pavarësisë. Ai mori pjesë në formacionet e organizuara të nacionalistëve që u ngritën gjatë kësaj periudhe.

Pas kapitullimit të Italisë, më 8 shtator 1943, situata politike në Shqipëri pati zhvillime shumë komplekse, si për nga orientimi i forcave politike, ashtu dhe për nga roli i tyre në realizimin e detyrës kryesore – çlirimin e vendit.

Përpyekjet e forcave politike shqiptare të rezistencës kundër pushtuesit në prag të kapitullimit, për t’u bashkuar në një front kombëtar të vetëm, ndonëse u finalizuan në Marrëveshjen e Mukjes, për fat të keq nuk u jetësuan në terrenin konkret.

Siç dihet, Marrëveshja e Mukjes u hodh poshtë nga Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar i mbledhur ditët e para të shtatorit 1943. në vend të bashkimit, PKSH, si drejtuese e Frontit Nacionalçlirimtar

⁷ *Po aty*, F. 271, V.1942, D.99/1, fl.284. Urdhër urgjent i zv.ministrit Gjonmarkaj dërguar prefekturës Elbasan, 24.02.1942.

shpalli vendimin për asgjësimin e Ballit Kombëtar dhe për vendosjen e pushtetit të vetëm të këshillave nacionalçlirimtare.

Me këtë vendim në kushtet e kapitullimit të Italisë, vendi ishte në situatën e një anarkie të rrezikshme të luftës civile.

Ndërkaq vendin e italianëve në Shqipëri e zunë forcat gjermane, të cilët, ndryshe nga italianët, shpallën se do të respektonin shtetin e pavarur shqiptar dhe politikën e saj neutrale në kushtet e luftës.

Në këto rrethana, pozita politike e Lef Nosit u përcaktua në përputhje me qëndrimin konstant të nacionalizmit shqiptar në situatën e re.

Personalitetet intelektuale shqiptare me shqetësimin e të ardhmes së shtetit të pavarur shqiptar, duke përfutur dhe nga politika gjermane që ofroi për shqiptarët, përcaktuan një qëndrim politik në interes të vendit. Qëndrimi inert i aleatëve ndaj fatit të shqiptarëve në fund të luftës, në një moment kyç të zhvillimit të ngjarjeve politike e ushtarake, ndikoi tek nacionalistët shqiptarë për ngjalljen e shpresës së krijimit të shtetit kombëtar, duke marrë në konsideratë dhe politikën e veçantë që ndoqën gjermanët në Shqipëri.

Aktivitetin më të dendur politik Lef Nosi e pati në këtë periudhë të ndërlikuar të situatës në Shqipëri, pas kapitullimit të Italisë dhe ardhjes së gjermanëve.

Lef Nosi ishte pjesë e atyre atdhetarëve shqiptarë që morën mbi vete një mision shumë të rëndësishëm për kombin shqiptar, ndonëse me shumë rreziqe personale.

Në mbledhjen e 16 tetorit 1943 të Kuvendit Kombëtar, Ibrahim Biçaku propozoi si kryetar të Kuvendit, Lef Nosit "si ma plaku që ishte"⁸. Me fjalën e tij si kryetar i Kuvendit, Lef Nosi shpalosi bindjet e tij si nacionalist dhe vizionin për të ardhmen e kombit shqiptar. Duke artikuluar probleme të mirëfillta që kishin të bënin me identitetin shpirtëror dhe territorial të shtetit shqiptar, edhe në situatë lufte, ai kishte guximin e një atdhetari të shprehte synimin dhe vijën politike të nacionalizmit tradicional shqiptar, për krijimin e një shteti kombëtar. Për Lef Nosit dhe bashkëpunëtorët e tij, duke pasur të qartë qëllimin, për të cilin u angazhuan në interes të kombit shqiptar, e përqendruan rolin e tyre politik në problemet e brendshme të Shqipërisë, për të ruajtur bashkimin kombëtar të shqiptarëve. Ndërsa, sipas tyre, problemet e luftës botërore në planin global, ishin atribut i faktorëve të tjerë jashtëshqiptarë. Edhe

⁸ *Bisedimet e Kuvendit Kombëtar*, Tiranë 1944, Mbledhja e parë 16 tetor 1943.

betimi i anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, që u bë nëpërmjet një formule të shqiptuar nga kryetari Lef Nosi, bëhej në emër të Perëndisë dhe mbi nderin, për “ruajtjen e mëvetësisë e tërësisë tokësore të Shqipërisë”, për kryerjen e detyrës me ndërgjegje të plotë, për të mirën e përgjithshme, pa u penguar aspak prej interesash të veçanta a krahinore.⁹

Është për t'u vënë në dukje se betimi u bë jo në emër të ndonjë ideologjie, por në emër të Perëndisë dhe të nderit, që për shqiptarët çmoheshin e vlerësoheshin shumë lart.

Me gojën e tij, Lef Nosi do të shpjegonte në punimet e Kuvendit Kombëtar dhe arsyen pse ai u riaktivizua në jetën politike. Ai argumentonte se “rishpallja e pavarësisë, pas kapitullimit të Italisë, solli prap në jetë sovranitetin tonë kombëtar, më 14 shtator 1943. Komiteti Ekzekutiv që u formua mori përgjegjësinë e rivendosjes së qetësisë në momente kaq të vështira dhe kritike”¹⁰.

Lef Nosi dhe bashkëpunëtorët e tij, që morën përsipër të drejtonin fatin e kombit shqiptar në atë situatë të vështirë, patën si moto “Bashkimi rreth flamurit. Ideologjinat e ndryshme nuk i njohim ... Fati i kombit shqiptar duhet të jetë i lidhur me jetën politike shqiptare e jokrahinore”.¹¹ “Gjermanofilia, rusofilia, komunizmi – do të shprehej Mihal Zallari, - vetëm përçarjen sjellin. Si popull i vogël duhet të jemi të bashkuar që të mund të rregullojmë punët tona”¹².

Nuk duhet harruar fakti se në vitin 1941 gjermanët sulmuan Jugosllavinë dhe e shpërbënë atë, por ata objektivisht çliruan Kosovën nga pushtimi i egër serb, madje, e bashkuan atë me Shqipërinë. Sigurisht, që ata e bënë për interesat e tyre gjeopolitike, por këto interesa përkonin me interesat madhore të shqiptarëve. U realizua ëndrra e kombit shqiptar – bashkimi kombëtar dhe funksionimi i shtetit të pavarur shqiptar në kushtet e luftës botërore.

Nacionalistët shqiptarë, sikurse Lef Nosi, aspironin ta ruanin bashkimin e të gjitha viseve shqiptare. Për këtë arsye ata u organizuan politikisht dhe shpallën shtetin shqiptar të pavarur, me një politikë neutrale dhe të qeverisjes së vendit mbi bazën e të gjithë legjislacionit të shtetit shqiptar të parapushtimit të vitit 1939.

⁹ *Po aty*, Mbledhja II, 18 tetor 1943.

¹⁰ *Po aty*, Fjala e Lef Nosit në mbledhjen e tretë të Kuvendit Kombëtar, 20 tetor 1943, f. 17.

¹¹ *Po aty*, Fjala e Xh. Mitrovicës në Kuvendin Kombëtar, Mbledhja III, f.23.

¹² *Po aty*, Fjala e Mihal Zallarit në Kuvend, Mbledhja III, f. 47.

Është pa asnjë bazë pikëpamja e të gjithë atyre që guxojnë të pretendojnë se këta nacionalistë ishin kundër Shqipërisë. Nacionalistët që morën përsipër organizimin dhe drejtimin e shtetit shqiptar ishin aktorë të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, siç ishin Lef Nosi, Mid'hat Frashëri, Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Ferit Vokopola etj. Ata ishin njerëz të ditur, përfaqësues të familjeve më të shquara të Shqipërisë, njerëzit më të respektuar dhe influencë në krahinat e tyre e më gjerë.

Edhe pse punuan e vepruan në kuadrin e një shteti sovran, re....., për arsye të Luftës Botërore, ata u përpoqën me çdo forcë për të mbetur neutralë. Ata shpresuan të bashkonin mbarë kombin shqiptar në një shtet kompakt, që do të mund të miratohej prej ngadhënjimtarëve, kushdo që mund të ishin ata (gjermanët apo aleatët). Shkurt, ata bënë realpolitikën e tyre.

Shteti shqiptar në vitin 1943-1944, në të cilën dha kontributin e tij Lef Nosi, bashkë me firmëtarët e tjerë të Shpalljes së Pavarësisë, nuk bashkëpunoi me komunistët, sepse komunizmin e identifikonin me Rusinë, mbështetësen historike të Serbisë, e cila ishte njëherësh armike historike e Shqipërisë. “Çunat janë të rinj, do të shprehej Lef Nosi për komunistët, - serbi jua ka me hile”. Siç duket, fati i Kosovës e shqetësonte Lef Nosin si politikan e atdhetar edhe në moshën 70-vjeçare, që e imponoi të rimerrej me politikë.

Komunistët që erdhën në pushtet, nëpërmjet edhe luftës civile në fund të luftës, e ndoqën Lef Nosin për ta arrestuar me akuzën “anëtar i Këshillit të Lartë të Regjencës dhe bashkëpunëtor i gjermanëve”. Për t'i shpëtuar prangave patrioti 70-vjeçar u detyrua të bënte një jetë ilegale në krahina të ndryshme të vendit, për të mos e braktisur atë. Megjithatë, ai nuk i shpëtoi terrorit komunist, që pas një gjykimi krejtësisht politik, u pushkatua më 20 shkurt 1945, së bashku me Anton Harapin dhe Maliq Bushatin. Kjo që ndodhi me Lef Nosin dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët luftuan me mish e me shpirt për shtetin kombëtar shqiptar, që në themelet e tij, në vend të vlerësimit për veprën atdhetare, përbën ironinë më të madhe të historisë së vërtetë.

Historia u ka shumë borxhe këtyre burrave të mençur e atdhetarë.